



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:046216

Datë: 26.02.2020

Numri i dokumentit: 00858384

P. nr. 289/2019

NE EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore-Departamenti Penal ne Prizren, me gjyqtarin gjykues Gani Kastrati, dhe procesmbajtesen Sh.B, në lëndën penale kundër të akuzuarit, Sh.D nga Prizreni, rruga "...", nr....., për shkak të veprës penale falsifikim i dokumentit nga neni 398. par. 2. të KP-së, sipas aktakuzës të PP/II nr.1772-5/18 të dt. 27.02.2019, pas mbajtjes së seancës të shqyrtimit gjyqësor, në prezencën e prokurorit te shtetit–Atnor Skoro, të akuzuarit dhe mbrojtësit te tij av. V.O nga Prizreni, me datë **18.02.2020** morri dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Kundër të akuzuarit

SH.D, nga i ati A., e ëma M. e gjinisë H., i lindur me datë ... në Prizren, me banim në rrugën “...” nr....., i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, Turk, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar sipas letërnjoftimit me numer personal lëshuar nga MPB në Prishtinë.

ESHTE FAJTOR

Prej datë 10.11.2017 i akuzuari si person përgjegjës i subjektit “...” L.L.C, si dhe bashkëpronar i kompanisë së sigurimit fizik “ ...”, me seli në Prizren përpilon dokument të falsifikuar, ndryshon dokumentin origjinal, me qëllim të përdorimit të atij dokumenti, në mënyrë që dokumenti të merr kuptim tjetër nga ai që ka dokumenti si origjinal, të cilin ndryshim e bënë me qëllim që të ketë vlerën provuse të tij, para organëve kompetente për ushtrimin e veprimtarisë financiare të kredive, lezingut financiar ndërmjetsimet monetare si dhe shërbime tjera financiare.

Me çka ka kryer veprën penale falsifikimi i dokumentit nga neni 398. par. 2. të KP.

Gjykata në bazë të nenit 4, 7, 41, 42, 43, 46,73. dhe nenit 398. parag. 1. të KPRP-së, si dhe nenit 365. të KPPK-ës, te akuzuarit i shqipton dënimin,

DËNIM ME GJOBË

Dënim me gjobë në shumën prej **400 € (katërqind euro)** të cilën shume duhet ta paguaj në afat prej 15 ditëve, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë dhe

Nëse dënimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas nenit 46 KPK-së, atëherë i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgu, në kohëzgjatje prej **20 ditësh** duke llogaritur për çdo ditë burgu nga **20 € (njëzet euro) të gjobës**

Detyrohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet gjyqësore të procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor në shumën prej **20 euro**, për ekspertizë mjekësore shumën prej **20 euro**, në emër të kompensimit të viktimave të krimit në shumën prej **30 euro**, në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi nën kërcenim të ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritë Aktakuzë PP/II nr.1772-5/18 të dt. 27.02.2019, kundër të akuzuarit Sh.D për shkak të veprës penale të falsifikimi i dokumentit nga neni 398 par.2 të KP, dhe ka propozuar që të akuzuarin ta shpall fajtor, të dënohet sipas Ligjit dhe të obligohet në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore.

Gjykata ka mbajtur seancen e shqyrtimit fillestar dhe ate ne prezencen e paleve pasi qe u lexua Aktakuza nga ana e Prokurorit te shtetit, gjykata shpalosi dhe beri prezantimin e te gjitha provave materiale me te cilat mbeshtetet aktakuza e parashtruar ndaj te akuzuarit Sh.D. I akuzuari deklaroi nuk i kundërshton provat me te cilat mbeshtetet aktakuza, andaj edhe ne menyre vullnetare ka pranuar fajesine per vepren penale me te cilen ngarkohet – vepren penale falsifikimi i dokumentit nga neni 398. par. 2. të KP. I akuzuari Sh.D në shqyrtimin fillestar deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën akuzohet sipas dispozitivit të aktakuzës, duke arsyetuar se këtë veprim e kam bërë nga pakujdesia, nuk kam menduar se do të ketë ndonjë pasojë, nuk e kam vënë asnjë organ në lajthim, është hera e parë dhe e pa qëllimt, e lus gjykatën që të më dënoj me një dënim sa më të but.

Mbrojtësi i të akuzuarit avokati V.O ne shqyrtimin fillestar deklaroi se gjendja faktike e pershkruar si ne dispozitiv eshte vertetuar nga vet pranimi i fajesise nga i akuzuari te cilen i propozoj gjykates ta vlersoj si rrethan lehtesuese me rastin e marjes se vendimit mbi dhenijen e lartesise se denimit, si dhe ta vlersoj rrethanen lehtesuese faktin e qasjes korekte te akuzuarit

gjate tere procedures penale, faktin se i njejt i kete veprim e ka bere nga pakujdesia, vertetimi i leshuar i cili eshte objekt i akuzes nuk eshte shfrytezuar ne asnje institucion publik por eshte leshuar per subjektin tjetër i cili poashtu menaxhohet nga i akuzuari, andaj thekson mbrojtësi i tij se shqiptimi i nje denimi me gjobe do te arrinte efektin ligjor te parapare me Ligj.

Prokurori i shtetit nuk e kundërshton pranimin e fajësise nga ana e ketu te akuzuarit, meqenese i njejt i me pranimin e fajësise sa i perket vepres penale e ka bere vullnetarisht qe eshte ne pajtim me nenin 248.te KPP-se.

Gjykata nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe provave materiale në shkresat e lëndës, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se me datë 10.11.2017 i akuzuari si përsone përgjegjës i subjektit “...” L.L.C, si dhe bashkëpronar i kompanisë së sigurimit fizik “ ...”, me seli në Prizren përpilon dokumentet të falsifikuar, ndryshon dokumentin origjinal, me qëllim të përdorimit të atij dokumenti, në mënyrë që dokumenti të merr kuptim tjetër nga ai që ka dokumenti si origjinal, të cilin ndryshim e bënë me qëllim që të ketë vlerën provuse të tij, para organëve kompetente për ushtrimin e veprimtarisë financiare të kredive, lezingut financiar ndërmjetsimet monetare si dhe shërbime tjera financiare

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit Sh.D i cili në shqyrtimin fillestar, vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për veprën penale për të cilat akuzohet, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat. Gjykata sipas detyrës zyrtare nuk ka gjetur se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari, ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë, dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht nga ana e tij, se pranimi i fajësisë mbështet në fakte dhe prova të çështjes që përmban aktakuza dhe se i akuzuari prej fillimit të hetimeve e gjerë në këtë shqyrtim ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat i ka paraqitur përfaqësuesi i aktakuzës dhe të cilat asnjëherë nuk i ka kundërshtuar dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruara si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre.

Me rastin e matjes së dënimit, Gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së të cilët ndikon në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit, si rrethanë lehtësuese, Gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, sjelljen korrekte e të akuzuarit, faktin se më parë nuk ka qenë i dënuar për asnjë vepër penale, të cilat rrethana ndikuan që Gjykata të akuzuarit ti shqiptoi dënim me gjobë në shumën prej **400€ (katërqind euro)**

Vendimet mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor, është marrë konform nenit 450 parg.1 dhe 2 nën parag.2.6.të KPPK-së.

Vendimi për programin e kompensimit e viktimave te krimit u marrë në kuptim të nenit 39 par.3 pika 1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit me Nr.05/L-036.

Nga sa u tha më lartë u vendos si ne dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2018:046216, 18.02.2020

G j y q t a r i

Gani Kastrati

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.

Numri i lëndës: 2018:046216
Datë: 26.02.2020
Numri i dokumentit: 00858384